Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/26
Datë: 02.02.2024

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, nenit 5 paragrafi 4, 5 dhe 6 si dhe nenit 6 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 01/196 e punës e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 26.01.2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **Akreditohet dhe validohet** " Instituti AAB për Kontabilist dhe Auditor të Certifikuar" me adresë: Rr. Elez Berisha, nr. 56, Zona Industriale Prishtinë, Republika e Kosovës, Ndërtesa e Kolegjit AAB, 10 000 Prishtinë, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 26.01.2024 deri 25.01.2027, me kualifikimet e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK):

   1.1 Auditor i Brendshëm i Certifikuar, Niveli V sipas KKK, lloji: Kualifikimet e bazuara në standarde ndërkombëtare (E) me 85 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit në dy (2) grupe brenda vitit, me pesëdhjetë (50) kandidatë në një grup, gjithsejë 100 kandidatë brenda vitit kalendarik.

   1.2 Kontabilist i Certifikuar, Niveli V sipas KKK, lloji: Kualifikimet e bazuara në standarde ndërkombëtare (E) me 55 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit në dy (2) grupe brenda vitit, me pesëdhjetë (50) kandidatë në një grup, gjithsejë 100 kandidatë brenda vitit kalendarik.

   1.3 Auditor i Certifikuar, Niveli V sipas KKK, lloji: Kualifikimet e bazuara në standarde ndërkombëtare (E) me 90 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit në dy (2) grupe brenda vitit, me pesëdhjetë (50) kandidatë në një grup, gjithsejë 100 kandidatë brenda vitit kalendarik.

1.4 **Teknik i Kontabilitetit, Niveli IV sipas KKK**, lloji: Kualifikimet e bazuara në standarde ndërkombëtare (E) me 50 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit në dy (2) grupe brenda vitit, me pesëdhjetë (50) kandidatë në një grup, gjithsejë 100 kandidatë brenda vitit kalendarik.

2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Institucioni " Instituti AAB për Kontabilist dhe Auditor të Certifikuar" me datë 31.05.2023 ka parashtruar në AKK kërkesë për akreditim dhe validim për kualifikimet: Auditor i Brendshëm i Certifikuar niveli V sipas KKK, Kontabilist i Certifikuar niveli V sipas KKK, Auditor i Certifikuar niveli V sipas KKK, Teknik i Kontabilitetit niveli IV sipas KKK.
AKK bazuar në dispozitat ligjore në fuqi ka zhvilluar procedurat për vlerësim të institucionit sa i përket plotësimit të kritereve dhe standardeve të përcaktuara për akreditim dhe validim nga AKK sipas legjislacionit në fuqi.
Pas realizimit të vizitës nga ekipet e ekspertëve në këtë institucion dhe trajtimit në detaje të dokumentacionit, ekipet e ekspertëve në raportet përfundimtar të hartuara ka dhënë vlerësim pozitiv, dhe të njëjtat ia rekomanduan Këshillit Drejtues për vendimmarrje.

Rekomandimet përfundimtare të ekipeve të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për akreditim dhe validim me kualifikimet si më lartë si institucion ofrues, vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e vetëvlerësimit; Vizitat e ekipeve të ekspertëve në "Instituti AAB për Kontabilist dhe Auditor të Certifikuar", si dhe dokumente tjera shtesë.

Andaj, në bazë të kërkesës së "Instituti AAB për Kontabilist dhe Auditor të Certifikuar" për akreditim dhe validim si dhe rekomandimeve përfundimtare të ekipeve të ekspertëve të dhëna në Raportet e vlerësimit për institucionin aplikues, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Dr. Besim Mustafa
Kryetar i KD të AKK-së

Vendimi u dërgohet:
1."Instituti AAB për Kontabilist dhe Auditor të Certifikuar"
2. Arkivit të AKK-së.